



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

Nr. 122/14 prot.

Vlorë, më 26.04.2021

VENDIM

Nr. 11, datë 21. 04. 2021

**PËR
MIRATIMIN E PROCEDURËS SË APLIKIMIT, MIRATIMIT, IMPLEMENTIMIT
DHE PAGESËS SË MINI- PROJEKTEVE TË FINANCUARA NGA
BUXHETI I UV-SË**

Mbështetur në nenin 40 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenin 26 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Rektorati në mbledhjen e datës 21. 04. 2021,

VENDOSI:

1. Të miratojë procedurën e aplikimit, miratimit, implementimit dhe pagesës së mini- projekteve të financuara nga buxheti i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. (procedura bashkëlidhur).
2. Kjo procedurë hyn në fuqi për zbatim për vitin akademik 2021- 2022 dhe në vazhdim.
3. Për projekt- propozimet e paraqitura me kërkesat buxhetore për vitin 2021, do të vlerësohen me vendimarrje nga Departamenti, Dekanati si dhe Rektorati dhe nuk i nënshtrohen kësaj procedure.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Njësitë Bazë, Njësitë Kryesore, Drejtuesit e Qendrave Kërkimore Shkencore si dhe Qendra RDC në UV.
5. Vendimi i përcillet për miratim të mëtejshëm Senatit Akademik.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Roland ZISI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORATI

PROCEDURË PËR PROJEKTE TË VOGLA

Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 93 "Veprimtaria kërkimore-shkencore", Neni 94 "Struktura e kërkimit shkencor" dhe Neni 95: "Kërkimi Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë" pika 1; Udhëzimit Nr. 29, datë 10-09-2018, si dhe skenarit 1, 2 dhe 3 të Planit Strategjik të UV, Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës hap thirrje për aplikim në projekte të vogla të financuara nga UV.

Hyrje

Projektet e vogla që Universiteti "Ismail Qemali" i Vlorës (UV) financon kanë si qëllim iniciativa të ndryshme për përmirësimin e nevojave të UV dhe kapaciteteve të veta. Grantet e vogla të UV përfshin një Kërkesë Specifike të Publikuar dhe ofron detaje në lidhje me një fushë të përgjithshme me interes, duke përcaktuar afatet kohore për rishikim dhe aprovim dhe për të marrë vendimet përfundimtare të grantit. Përfituset e projektit kanë përgjegjësinë për hartimin, zbatimin dhe kryerjen e iniciativës së kërkuar.

Kriteret e pranueshmërisë

- Mund të aplikojnë pedagogë ose grupe pedagogësh (max 10 vet) me kohë të plotë të Njësive Bazë dhe Kryesore të UV-së;
- Të kenë eksperiencë në punë të paktën 1 vit;

Fusha e projektit

- Fushat në të cilat UV ofron programe studimi;
- Fushat prioritare sipas Planit Kombëtar të Zhvillimit;
- Fushat prioritare sipas Planit Strategjik të UV-s;
- Fusha prioritare që mund të caktojnë Njësitë Bazë e Kryesore;

Shuma monetare për projektin

- Shuma monetare maksimale që mund të ofrohet në kuadër të secilit projekti varet nga buxheti i miratuar si dhe prioritetet e Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë;

Data përfundimtare e aplikimit

- Data përfundimtare për dorëzimin e aplikimit është një muaj pas shpalljes së thirrjes;



Data përfundimtare e miratimit të projektit

- Data përfundimtare për informimin e fituesve është 20 ditë pas dorëzimit të aplikimit;

Data përfundimtare për dorëzimin e projektit të përfunduar

- Data përfundimtare për dorëzimin e aplikimit të përfunduar të projektit është gjashtë deri në dymbëdhjet muaj pas shpalljes së rezultateve;

Mënyra e aplikimit

Faza e parë

1. Hapja e thirrjes dhe aplikimi

Thirrja për aplikim në mini-projekte shpallet pas miratimit të buxhetit të UV-së. Në bazë të kësaj thirrje, të gjithë të interesuarit janë të detyruar të dorëzojnë pranë Dekanit të Fakultetit një projekt-propozim (Formati 1) ku do të prezantohet titulli i studimit, qëllimi i studimit, metodologjia, grupi i punës (koordinatori dhe stafi mbështetës), buxheti i kërkuar për çdo zë etj. Në këtë fazë përcaktohet procesi se si do të zbatohet projekti nëse shpallet fitues. Po ashtu në këtë fazë do prezantohet planifikimi i detajuar për realizimin e detyrave dhe buxhetit të projektit (Formati 2).

2. Miratimi i projektit

Në bazë të aplikimeve, brenda 10 ditësh pas mbylljes së aplikimeve, Departamenti/et zhvillojnë mbledhje dhe shpallin projektin/et fitues. Dekani i Njesisë Kryesore cakton një komision të përbërë nga tre (3) ekspertë (dy brenda Njesisë Kryesore dhe një të jashtëm) për vlersimin përfundimtar të projekteve të miratuara nga Njësia Bazë. Kriteret për vlerësimin e projekteve janë: Relevanca, Efikasiteti, Efektiviteti, Impakti, Qëndrueshmëria (Formati 3). Vendimi i Komisionit i përcillet Drejtuesit të Njesisë Kryesore i cili ia përcjell Rektorit për informim. Prioritet në vlerësim do të kenë aplikues që nuk kanë aplikuar më parë.

3. Implementimi

Gjatë kësaj faze, fituesit e projektit janë të detyruar të implementojn projektin e fituar duke ndjekur të gjitha rregullat etike siç parashikohen nga UV. Gjatë gjithë procesit të implementimit Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Promovimit Akademik do të jetë në dispozicion të grupit kërkimor. Në këtë fazë grupi i punës është i detyruar të zbatoj me kujdes të gjitha detyrat e përcaktuara me qëllim implementimin e objektivave. Plani i zbatimit përbëhet nga të gjitha aktivitetet e parashikuara.

4. Përfundimi dhe dorëzimi

Para ditës përfundimtare të projektit (deadline) grupi/et kërkimore janë të detyruar të dorëzojnë rezultatet finale. Raporti përfundimtar miratohet nga Dekanati dhe Rektorati. Në rastet kur këto



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
REKTORATI

organe nuk miratojnë raportin, grupi i punës është i detyruar të bëjë korrigjimet/rregullimet sipas propozimeve. Në rastin se këto propozime nuk zbatohen, projekti quhet i dështuar dhe grupi i punës është i detyruar të kthejë mbrapa të gjithë shumën. Në rastet kur raporti përfundimtar miratohet, ky dokument i dorëzohet Rektorit, Administratorit, anëtarëve të Rektoratit, anëtarëve të Dekanatit në të cilin projekti u implementua si dhe Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse. Në dokumentin përfundimtar duhet të parashikohet edhe përhapja e rezultateve. Në këtë fazë duhet të prezantohen qartë rezultatet e projektit, arritjet, mos-arritjet dhe arsyet si dhe shpenzimet e bëra.

5. Fushat e projektit përfundimtar

Dokumenti i prezantimit të rezultateve përfundimtare duhet të përfshijë fushat e mëposhtme:

- a. Abstrakt
- b. Hyrje
- c. Qëllimi dhe objektivat
- d. Dizajnimi i projektit dhe metodologjia
- e. Ndryshimet e bëra nga objektivat origjinale (nëse ka të tilla)
- f. Implementimit i projektit
- g. Rezultatet
- h. Vlerësimi i rezultateve
- i. Rekomandime
- j. Konkluzionet
- k. Përfitimet e UV
- l. Diseminimi, përhapja dhe shfrytëzimi i rezultateve
- m. Menaxhimi i rreziqeve të shfaqura gjatë realizimit të aktiviteteve (nëse kishte të tilla)
- n. Shpenzimet e buxhetit
- o. Formati 4 i plotësuar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

Rregulla të përgjithshme

- Zbatimi i të gjitha rregullave dhe standarteve etike dhe profesionale;
- Drejtuesi i projektit duhet të krijoj një klimë të favorshme për bashkpunimin e ekipit të projektit;
- Puna e prezantuar është e saktë dhe të dhënat janë të vlefshme dhe të vërteta;
- Të zbatohen të gjitha rregullat financiare sipas Statutit, Rregullores dhe të gjitha vendimeve të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të UV.

Buxheti

Buxheti maksimal që grupet kërkimore kanë në dispozicion bazohet në buxhetin e miratuar nga BA për Njësinë Kryesore si dhe prioritetet që Njësia ka. Ky buxhet mund të përdoret për:

- Rrogë për stafin pjesmarrës në projekt;
- Matëriale kancelarie dhe promovuese (d.m.th. letër printeri, bojë për printerin, printim matërialesh etj.);
- Kosto lëvizje/udhëtimi;
- Pajisje;
- Publikime në revista të huaja në vende të BE, OECD ose G-20 dhe të cilat janë të indeksuara në Journal Citation Reports edhe/ose SCOPUS;

Të fundit

Kjo procedurë është e detyruar të zbatohet nga viti akademik 2021-2022. Projekt propozimet e paraqitura me kërkesat buxhetore për vitin kalenderik 2021 do të vlersohen nga Njësitë Bazë, Njësitë Kryesore dhe Dekanatet dhe do të miratohen në Rektorat.

REKTORI

Prof. Dr. Roland ZISI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË

Formati 1: Format Aplikimi i Projektit

Nr. Prot.

Vlorë, më ____ / ____ /2021

Lënda: Kërkesë për të Aplikuar për Mini-Projekte të financuara nga UV

Këtu:

KËRKESË PËR TË APLIKUAR PËR PROJEKT

I/E nderuar

Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 93 "Veprimtaria kërkimore-shkencore", Neni 94 "Struktura e kërkimit shkencor" dhe Neni 95: "Kërkimi Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë" pika 1; Udhëzimit Nr. 29, datë 10-09-2018, si dhe skenarit 1,2 dhe 3 të Planit Strategjik të UV, Ju përcjell kërkesën për aplikim në projektin me titullKy projekt-propozim ka si qëllim kryesor

INFORMACION I PËRGJITHSHËM I PROJEKT PROPOZIMIT	
Titulli i projektit	
Fusha ku aplikohet	
Drtejtuesi i projektit	
Grupi i punës i Projektit	
Qëllimi i studimit	



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE

Objektivat kryesore	
Kohëzgjatja e projektit (në muaj)	
Partnerët të jashtëm (nëse ka)	
Buxheti total i projektit	
Kapaciteti i grupit të punës	
Eksperiencia të mëparshme të grupit të punës	

Të dhënat e Drejtuesit të Projektit

Emër, mbiemër	
Institucioni	
Posti që mban	
Grada shkencore	
Adresa postare	
Adresa e e-mail	

1. Identifikimi i problemit dhe rëndësia e zgjidhjes (deri në 500 fjalë)
2. Lidhja e projekt-propozimit me prioritetet kombëtare strategjike dhe planin strategjik të UV (deri në 300 fjalë)
3. Qëllimi i projektit (deri në 100 fjalë)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE

- Objektivat specifike të projektit (deri në 500 fjalë)
- Aktivitetet e projektit (deri në 1000 fjalë)
- Metodologjia për realizimin e objektivave të projektit (deri në 1000 fjalë)
- Rezultatet e pritshme të projektit (deri në 300 fjalë)
- Përfitimiet e Universitetit nga aplikimi në këtë projekt (deri në 300 fjalë)
- Qëndrueshmëria e rezultateve (deri në 500 fjalë)
- Personeli që do të përfshihet në projekt

Grada shkencore	Emër mbiemër	Detyrat në projekt

11. Plani i punës

Aktiviteti/Muaji	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12

12. Plani i punës sipas objektivave specifike

Objektivi	Aktiviteti	Rezultati	Periudha kohore	Personi përgjegjës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË

Gjatë dhe pas përfundimit të projektit në emër të grupit të punës marr përsipër ti siguroj Njesisë Bazë/Njesisë Kryesore të gjithë dokumentacionin e projektit si dhe një kopje të plotë të raportit përfundimtar të projektit.

Faleminderit për bashkpunimin,

Grupi i punës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË

Formati 2: Formati i propozimit financiar

1. Titulli i projektit;
2. Drejtuesi i projektit;

Zëri në buxhet	Tipi	Sasia	Njësia	Vlerësimi i shpenzimeve në Mijë Lekë	Përshkrimi i detajuar
Pagat e personelit (e detajuar për drejtuesin dhe stafin)					
Udhëtime/dieta					
Seminare/konferenca					
Paisje					
Aktivitete					
Publikime/botime					
Shpenzime administrative					
Të tjera (detajo)					



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORE
FAKULTETI I

Formulari 3: Kriteret e vlerësimit të aplikimeve

VLERËSIMI I PROJEKTIT	
Relevanca (Shkalla në të cilën objektivat e projektit janë në përputhje me nevojat e UV, rajonit dhe politikat kombëtare). – 20 pikë	
Efikasiteti (A justifikohet përdorimi i burimeve të kërkuara nga aktivitetet që do të kryhen). – 20 pikë	
Efektiviteti (Shkalla në të cilën pritet të arrihen objektivat e ndërhyrjes duke marrë parasysh rëndësinë e tyre relative). – 20 pikë	
Impakti (Efektet pozitive dhe negative, primare dhe sekondare afatshkurtra dhe afatgjata të prodhuara nga projekti). – 20 pikë	
Qëndrueshmëria (Vazhdimi i përfitimeve nga projekti pasi të ketë përfunduar. Probabiliteti i përfitimeve afatgjata). – 20 pikë	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI 'ISMAIL QEMALI' VLORË

Formulari 4: Raporti përfundimtar i projektit

1. Përmbledhje e Rezultateve dhe të projektit (500 fjalë);
2. Justifikimi i ndryshimeve të realizuara (500 fjalë);

Qëllimi:		
Objektivi 1:		
Realizuar	Jo I realizuar	I ndryshuar
Detaje mbi objektivin 1 dhe rezultatin		

Qëllimi:		
Objektivi 2:		
Realizuar	Jo I realizuar	I ndryshuar
Detaje mbi objektivin 2 dhe rezultatin		

Buxheti

Zëri	Buxheti i parashikuar	Buxheti i realizuar	Detaje
Stafi			
Udhëtime/dieta			
Seminare/konferenca			
Paisje			
Aktivitete			
Publikime/botime			